



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Ftesë për dorëzim të propozimeve për artikuj

Rreth nismës

Kosovo 2.0 (K2.0) është një platformë e larmishme, e përkushtuar që të ofrojë gazetari të thellë dhe gjithëpërfshirëse. Me mbi 150 prodhime artikujsh në vit, ekipi dhe kontribuuesit/et tanë/ona vazhdimisht krijojnë përmbajtje që shpërblehen me çmime dhe shtjellojnë thellë kontekstin, historinë dhe pikëpamjet rreth Kosovës, rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe përtej. Me përvojë mbi 13-vjeçare, ne mburremi si ndër të rrallat revista online në rajonin tonë, që botohet në shqip, anglisht, boshnjakisht/serbisht/kroatisht, duke inkurajuar botimet e pavarura në të gjithë Ballkanin.

Modeli ynë i revistëa na ka fuqizuar të realizojmë projekte të shumta që synojnë mbrojtjen e lirisë së medias, sigurimin e qasjes së publikut në informata cilësore, si dhe shtyrjen e kufijve të gazetarisë multimediale, eksperimentimin me formatet dhe rrëfimtarinë e guximshme. Një nga fushat kryesore në të cilat përqendrohet K2.0 është adresimi i çështjeve që kanë të bëjnë me të kaluarën, kujtesën dhe drejtësinë tranzicionale. Si pjesë e mbulimit tonë të vazhdueshëm të këtyre temave kritike, ne aktualisht po zbatojmë projektin e titulluar "Arkivi i shërimit: Gazetaria për pajtim". Kjo nismë i dedikohet mbështetjes së përpjekjeve gazetareske që përqendrohen rreth këtyre temave, duke ofruar pikëpamje si nga Kosova, ashtu edhe nga rajoni më i gjerë.

Projekti ynë është pjesë e projektit më të madh rajonal "Mbështetja e BE për ndërtimin e besimit në Ballkanin Perëndimor", i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.

Çfarë po kërkojmë?

Ne ftojmë gazetarë/e, profesionistë/e të medias, studiues/e, shkrimtarë/e dhe të tjerë që kanë aftësi të prodhojnë përmbajtje gazetareske, të dërgojnë propozime me ide lidhur me temat e projektit tonë. Propozimet duhet të përfshijnë ide për përmbajtjen/shkrimin e një artikulli, i cili do të redaktohet dhe botohet në K2.0.

Nëpërmjet këtyre propozimeve po kërkojmë të prodhojmë artikuj që plotësojnë këto kushte:

1. Artikujt duhet të përmbajnë nga 2000 deri në 2500 fjalë.
2. Duhet të jenë të shkruar fillimisht në gjuhën shqipe, boshnjake/kroate/serbe ose angleze.

K2.0



Financuar nga
Bashkimi Evropian



3. Artikujt duhet të ofrojnë pikëpamje që bazohen në fakte, janë të përqendruar te të drejtat e njeriut, intervista ose rrëfime për tema që kanë të bëjnë me të kaluarën, kujtesën dhe drejtësinë tranzicionale.
4. Shtrirja gjeografike mund të jetë në Kosovë, një vend tjetër i Ballkanit Perëndimor, rajoni në tërësi, ose një kombinim i tyre.

Kandidatët/et që përzgjidhen pritet të angazhohen në mënyrë aktive në sesione të shumta gjithëpërfshirëse redaktimi nga K2.0, për t'i përfunduar artikujt e tyre përpara botimit.

Si të dërgoni propozimet?

Ne mirëpresim propozime nga persona të interesuar, të cilat duhet të përfshijnë:

1. Të dhëna mbi idenë për artikull: Jepni përgjigje të qarta dhe përmbledhëse ndaj këtyre pyetjeve: Me çka ka të bëjë rrëfimi? Cili është këndvështrimi i veçantë mbi idenë? Cilat janë personazhet kryesore? Pse ka rëndësi ky rrëfim tani? Pse je personi i duhur për ta rrëfyer atë? Propozimi juaj për ide duhet të jetë i gjatë dy deri në tre paragrafë dhe ta saktësojë gjuhën në të cilën do ta shkruani.
2. Ofertën financiare: Jemi të gatshëm të paguajmë deri në **300.00 EUR bruto bruto** për një artikull. Kjo pagesë mbulon të gjitha shpenzimet që lidhen me shkrimin e tij.
3. Curriculum vitae (CV): Theksoni përvojën tuaj përkatëse në gazetari, në shkrime dhe temat e projektit. Sigurohuni ta përmendni çdo punë të mëparshme me K2.0.

Propozimet duhet të dërgohen në info@ktwopointzero.com në format Word ose PDF, në anglisht, boshnjakisht/kroatisht/serbisht ose shqip. Është përgjegjësi vetëm e autorit/es të/së ardhshëm/me të sigurohet që dokumentet mund të lexohen dhe hapen. Po ashtu, duhet të ofrojnë informata të plota, të sakta dhe në përputhje me thirrjen lidhur me propozimin e tyre, përndryshe rrezikojnë të përjashtohen.

Më shumë informata lidhur me propozimet për artikuj

Bazuar në prioritetet tona redaktoriale, K2.0 ka përmendur idetë e mëposhtme për artikuj. Përderisa do t'u japim përparësi fushave që përputhen me këto ide, mbesim gjithashtu të hapur për propozime tjera. Kur ta dorëzoni propozimin tuaj, ju lutemi saktësoni nëse po përzgjidhni njërin nga idetë e mëposhtme, duke përshtatur njërin prej tyre ose duke propozuar një ide krejtësisht origjinale. Secili/a mund të propozojë maksimum një ide për një artikull specifik.

K2.0



1. Kultura dhe Artet

Shtjellimi i mënyrave se si skena artistike e Kosovës përkujton luftën dhe formëson kujtesën kolektive.

2. Roli dhe përgjegjësia institucionale

Hulumtimin e rolit të institucioneve të Kosovës në drejtësinë e pasluftës, pajtimin dhe ballafaqimin me të kaluarën, duke përfshirë rolin e tyre në dokumentimin e krimeve dhe kujtimeve të luftës.

3. Përvojat personale

Rrëfimi i historive dhe përvojave personale të të prekurve/ave nga lufta e Kosovës, duke ofruar pikëpamje njerëzore mbi qëndrueshmërinë dhe rindërtimin.

4. Aktivizmi

Prezantimi i historive të aktivistëve/eve të pasluftës, duke shqyrtuar thellë përpjekjet e tyre të vazhdueshme për ta adresuar faktin se sa i ndërlikuar është ballafaqimi me të kaluarën dhe avokimi për drejtësinë tranzicionale në Kosovë.

5. Kujtesa kolektive

Shtjellimi i ndërtimit të Kosovës dhe ruajtjes së kujtesës kolektive, duke shqyrtuar se si narrativat e përbashkëta formësojnë identitetin kombëtar të pasluftës. Shqyrtimi i rolit të përkujtimeve dhe hapësirave publike në formësimin e kujtesës kolektive të luftës së Kosovës.

6. Kujtesa ndër breza

Hulumtimi i sfidave dhe mundësive të dialogut ndër breza, duke shqyrtuar se si brezat e rinj angazhohen me trashëgiminë e luftës.

7. Narrativat e luftës

Shtjellimi mbi mënyrat se si narrativat e luftës mirëmbahen në mënyrë aktive sot në sferën publike, duke shpërfaqur ndikimin e vazhdueshëm të historive që kundërshtohen, miteve dhe përfaqësimeve mediale në kujtesën kolektive të luftës.

Forma e vlerësimit

Një komision vlerësues i përbërë nga ekipi i K2.0 do t'i zgjedhë deri në pesë (5) propozime për artikuj. Gjatë vlerësimit, komisioni do të marrë parasysh:

1. Pagesa që kërkohet;
2. Cilësia e propozimit për artikull;
3. Lidhshmëria e propozimit të idesë me temat dhe objektivat e projektit, së bashku me përafrimin me prioritetet redaktoriale dhe qasjen e K2.0;
4. Përvojën e kandidatit/es.

Pas përzgjedhjes, K2.0 ka të drejtën e posaçme për të bashkëpunuar me autorin/en(ët/et) në qartësimin/përpunimin e propozimit sipas nevojës.

Afati kohor

K2.0



4 mars 2024	Ftesa për propozime për artikuj
22 mars 2024*	Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve
Mars 2024	Informacion autorëve/eve të mundshëm/me lidhur me vlerësimin e propozimit të tyre
Qershor 2024	Dorëzimi i drafteve të artikujve në K2.0 nga autorë/et e përzgjedhur/a
Qershor - Korrik 2024	Redaktimi
Gusht 2024	Botimi

Ky dokument është i qasshëm në gjuhën angleze, shqipe dhe boshnjake/serbe/kroate. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

* [Shënim] Afati fillestar për dërgimin e propozimeve në kuadër të kësaj thirrjeje ka qenë 17 Mars, 2024. Që nga 15 Marsi, 2024, ky dokument është përditësuar për të zgjatur afatin deri në 22 Mars, 2024.